

ISSN: 1857-8896

INSTITUTI ALB-SHKENCA  
ALB-SHKENCA INSTITUTE

**AA**  
**Studia humanitatis**

**20**



ANAS Viti VII

Nr. 20

Fq. 1-105

Shkup

2022



## Studia humanitatis

# 20

20/2022

Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga:



Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shkup, 2022

## Studia humanitatis

## 20

Botues Instituti Alb-Shkenca	Editor Alb-Shkenca Institut
Redaktori përgjegjës Prof. dr. Zeqirja NEZIRI "Shën Cirili dhe Metodi", Maqedoni	Editor-in-chief Zeqirja NEZIRI, PhD., University "St. Cyril and Metodij", Macedonia
Zëvendës redaktorë Prof. dr. Shpresa HOXHA (Universiteti i Prishtinës, Kosovë) Prof. dr. Kristaq JORGO (Universiteti i Tiranës, Shqipëri)	Vice editors Shpresa HOXHA, PhD (University of Pristina, Kosovo) Kristaq JORGO, PhD (University of Tirana, Albania)
Redaksia (Shqipëri) Emil LAFE (SHBA) Sami REPISHTI (SHBA) Niko QAFOKU (Maqedoni) Zeqirja NEZIRI (Kosovë) Shpresa HOXHA (Shqipëri) Kristaq JORGO (Maqedoni) Mustafa IBRAHIMI (Shqipëri) Lluka QAFOKU (SHBA) Robert MAGARI (Kosovë) Arbnora DUSHI (Kosovë) Nebi CAKA (Shqipëri) Merita SAUKU BRUCI (Maqedoni) Agim LEKA (Kosovë) Arben HOXHA	Editorial board: <sup>14/4</sup> Emil LAFE (Albania) ✓ Sami REPISHTI (USA) ✓ Niko QAFOKU (USA) Zeqirja NEZIRI (Macedonia) ✓ Shpresa HOXHA (Kosovo) ✓ Kristaq JORGO (Albania) Mustafa IBRAHIMI (Macedonia) Lluka Qafoku (Albania) Robert MAGARI (USA) Arbnora DUSHI (Kosovo) Nebi CAKA (Kosovo) Merita SAUKU BRUCI (Albania) Agim LEKA (Macedonia) Arben HOXHA (Kosovo)
Redaktor teknik Prof. dr. Mustafa IBRAHIMI	Technical editors Mustafa IBRAHIMI, PhD.

## Përmbajtja

<b>PËRMBAJTJA – CONTENTS.....</b>	<b>3</b>
ZEQIRJA NEZIRI.....	5
<b>MITRUSH KUTELI DHE STUDIMET STILISTIKE (GJUHËSORE DHE LETRARE) .....</b>	<b>5</b>
EMIL LAFE .....	21
<b>DISA SHËNIME PËR ECURINË E ZHVILLIMIT TË SHQIPES SË SHKRUAR PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË .....</b>	<b>21</b>
MUSTAFA IBRAHIMI .....	37
<b>ÇËSHITJE ONOMASTIKE NË VEPRËN E PIETËR BOGDANIT DHE ATO TË JERONIM DE RADËS .....</b>	<b>37</b>
FATMIRE VEJSELI .....	47
<b>ANALIZË E BALADËS “ZOTI DHE BAJADERA” SIPAS ASPEKTIT TEOLOGJIK DHE MITOLOGJIK NGA JOHAN VOLFGANG GËTE.....</b>	<b>47</b>
ELONA GJELAJ.....	55
<b>SISTEMI TATIMOR I FSHATARËSISË DHE EFEKTI QË PATI NË EKONOMI NË REGJIMIN KOMUNIST.....</b>	<b>55</b>
SUNAJ RAIMI DHE AVNI AVDIU.....	61
<b>ROLI DHE NDIKIMI I INTERNETIT TE STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË TETOVËS DHE KOLEGJIT ILIRIA .....</b>	<b>61</b>
NELI NAÇO.....	67
<b>ETNIKJA SI FILLESË: PIKËVËSHTRIMI DHE VENDNDODHJA NË POEZINË “PORADECI” .....</b>	<b>67</b>
AVNI AVDIU .....	73
<b>PROBLEMATIKA E LIGJËRIMIT VIRTUAL FETAR.....</b>	<b>73</b>
LULJETA ADILI ÇELIKU MERAL VESELI, FARKETA DIBRA-ZEQIRË .....	83
<b>VESHJA POPULLORE E GRUAS SHQIPTARE NË KËRÇOVË .....</b>	<b>83</b>
ARGËTIM RAIMI .....	93
<b>FAMILJA SI BËRTHAMË E SHOQËRISË DHE PJESËT KONSTITUTIVE TË SAJ .....</b>	<b>93</b>

**Referenca:**

1. Sinani, Gjergj, *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë, 2017
2. Zguri, Rrapo, *Analizë e diskursit ekstremist fetar në media*, Albanian Media Institute [Instituti Shqiptar i Medias], Tiranë, 2016
3. Ulqini, Kahreman, *Toleranca fetare e shqiptarëve në zigzaget e historisë*, Fiorentia - verba volant scripta manet, Shkodër, 2016
4. Locke, John, *Letër për tolerimin*, Plejad, Tiranë, 2002
5. <https://www.trtworld.com/middle-east/saudi-clergy-jumps-through-hoops-to-legalise-crown-prince-s-reforms-23747> & <https://www.youtube.com/watch?v=va9WB8dR18Q> <https://www.youtube.com/watch?v=OFumEekhSSs> & <https://www.youtube.com/watch?v=Itcf8klv4Xs> <https://www.youtube.com/watch?v=CeWRA4iZqRo> & <https://www.youtube.com/watch?v=R7Vpy7SDqyk> <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=3015> & <https://www.youtube.com/watch?v=ol63nb5zfo0> <https://www.youtube.com/watch?v=ISsNY-S4g4E> & <https://www.youtube.com/watch?v=r1627CO4XgA> <https://www.youtube.com/watch?v=crMagMRmTuU&> <https://www.youtube.com/watch?v=hmer-De0NvQ>

ISSN 1857-8896

Nr. 20, Shkup 2022

Punim studimor

Doc. dr. Luljeta Adili Çeliku, UKIM, Shkup

[l.adili@fif.ukim.edu.mk](mailto:l.adili@fif.ukim.edu.mk)

Doc.dr. Meral Veseli, SEEU, Tetovë

[m.shehabi2@seeu.edu.mk](mailto:m.shehabi2@seeu.edu.mk)

Doc.dr. Farketa Dibra Zeqiri, UKIM, Shkup

[farketadibra@gmail.com](mailto:farketadibra@gmail.com)

## VESHJA POPULLORE E GRUAS SHQIPTARE NË KËRÇOVË

Veshja tradicionale popullore shqiptare paraqet një nga manifestimet më të fuqishme kulturore. Nëse një vend ka veshje popullore, kjo nënkupton se ai vend ka histori, ka traditë, ka paraardhës dhe lë trashëgimi brez pas brezi veshjet, pra në atë vend duhen kërkuar gjurmë historike. Një vend i tillë është qyteti i Kërçovës me fshatrat e tij përreth. Kërçova ka një veshje shumë të veçantë popullore, sidomos atë të grave, veshje kjo që në shumë elemente ngjan me veshjet e trojeve tjera shqiptare, por dhe shumë elemente i ka unike si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja e saj. Në veshjet popullore kërçovare gjenden shumë elemente ilire, të cilat mund lirisht të themi se janë lehtë të dallueshe, duke filluar nga gjatësia e këmishës, nga forma e saj, ashtu edhe nga përmbajtje, si: ngjyra e saj e bardhë, simbolika që bart kjo veshje, motivet e larmishme që dallohen në këtë veshje, si: antropomorfe, kozmike, zoomorfe, fitonime e shumë të tjera, të cilat do t'i trajtojmë më poshtë në mënyrë të detajuar.

Ajo që e bën më tërheqëse këtë veshje është veçantia e saj, e cila mund të krahasohet drejtpërdrejt me veshjet e lashta ilire, gjë që tregon për autoktoninë e kërçovarëve. Askush më fortë se kjo veshje nuk tregon një lidhje të drejtpërdrejtë me ilirët e lashtë. Ruajtje e kësaj veshjeje ndoshta ka ndodhur nga pozita gjeografike që ka Kërçova me fshatrat e saj. Është vend i rrethuar me male dhe nuk ka mundur lehtë të hyjë ndikimi i elementeve tjera për zhberjen e kësaj perle të paçmuar, e cila ka ngelur

unike dhe e ngjajshme njëkohësisht me veshjen e një ilireje. Jo rastësisht janë krenarë kërcovarët që kanë një veshje kaq të bukur dhe me kaq vlera të larta etnografike dhe sot e gjithë ditën e ruajnë me një fanatizëm të madh.

Gjuhëtari, prof. dr. Qemal Murati, ka shkruar për veshjen e këtij vendi, pasi dhe vetë vjen nga Kërçova. Ai ka bërë që veshja të dalë edhe jashtë kufijve e të marrë dhenë dhe të mahnisë shumë njerëz që nuk e kishin parë më parë atë. Kemi edhe studiues të tjerë që i ka joshur kjo pasuri materiale e shpirtërore të cilët bënë që kjo veshje të radhitet krahe për krahe me veshjet tjera kombëtare e ndërkombëtare, si: prof. dr. Hamit Xhaferri, akademik Feti Mediu etj. Një punë me vlera të larta ka bërë edhe doc.dr. Luljeta Adili-Çeliku me mbledhjen e këngëve në librin "100 këngë dasmash" ku ka paraqur këngët e grave dhe nuset të veshura me veshje tradicionale. Nëpërmjet paraqitjes së këngëve ka përfshirë edhe veshjen e ditës përkatëse të dasmës, këngë përkatëse për veshjen përkatëse, të gjitha këto vijnë nga ky vend me tradita të lashta, me një art të begatë i dalë nga gra të panjohura në fushën artistike. Gra që nuk patën fatin të ngjiten në skena të mëdha e të këndojë apo të sfilojnë me veshjet e krijuara, nuk patën fatin të jenë autore të këngëve dhe valleve që krijuan. Asnjëra nuk u njoh me emër të përveçëm, por ngelën vetëm gra, kurse këngët e tyre ngelën këngë grash e veshja veshje grash dhe asgjë më tepër.

Gruaja ka qënë dhe është ura lidhëse në çdo gjë që ka një popull, gjithçka që posedon njerëzimi, si materiale ashtu edhe shpirtërore. Ajo pati një rol shumë të rëndësishëm edhe në veshjen e familjes së saj, me duart e saj përveç që duhej të gatonte e ta ushqente familjen, ajo duhej edhe t'i vishte ata, si në raste festash ashtu edhe për veshjen e përditshme të anëtarëve të familjes. Nuk blehej thujse asgjë në qytet, as këmisha e as tirqët, as shamia e as plisi, as opingat e as çorapet... të gjitha duhej të përshkoheshin nëpër duart e grave. Por, sigurisht që ajo nuk do t'i linte veshjet pa mos i zbukuruar, pa mos ia dhënë një dorë shpirt nga shpirti artistik që fshihej në të. Them i fshihej, pasi ishte e vetmja mënyrë për ta treguar botën artistike që e kishte në shpirt të saj. Shpeshherë ndodhte që arti të lindte dhe vdiste bashkë me atë pa mos iu dhënë mundësia për ta treguar ose bartur te të tjerët.

E mbajmë mend kur tregonte gjyshet se si i bënin veshjet, si i tirnin dhe si i thurnin ato. Leshin e merrnin nga delet e linin dhe konopin e mbillnin, mëndafshin e rritnin në "gjirin" e tyre, të gjitha procedurat e përgatitjes së materialit e deri te përfundimi i veshjes e bënin vetë. Gjatë kohë, deri vitet 90-ta, gjyshja e mbante tullarin me te cilin vejte këmisha e mbulesa që ua përgadiste vajzave që do të bëheshin nuse.

Gratë shpesh tregojnë histori të ndryshme se si janë përgatitur për t'u bërë nuse. Se çfarë impenjimi duhej për t'u "bërë gate:j", kanë gëdhirë net të tëra duke "vejtur në tullar", pasi ditën kishin edhe punë tjera, punët e fushës edhe të manxhes, nuk i kursente njeri për asgjë. Vajzat, që nisnin

pajën, përveç që shkonin të marrin "irrnek" te shoqet tjera, mundoheshit të bëni diçka të veten, të nxjerrin "*irrnek të ri*" dhe pastaj të njejtin e ruanin me fanatizëm që mos ua kopjojnë dhe e bën dikush si ato dhe e vesh pastaj në dasëm para atyre. Dasma ishte vendi ku ato do të performonin me atë që ato e kishin krijuar vetë "*fund e krye*".

Gratë e shihnin njëra-tjetrën me një vëmendje të madhe, se sa bukur apo keq i kishin qëndisur veshjet e tyre, çfarë këmishë dhe hojash kishin vënë, a kanë "*irrneçe të reja*" apo kanë ato të vitit të shkuar. Nëse dikush kishte diçka të re, menjëherë merreshte në pyetje se si e ka bërë, me çfarë e ka bërë që ta bëjnë edhe ato. Nëse e ka veshur graujat atë që e ka "çit" vetë, pastaj nuk ishte problem nëse dikush tjetër e merret që ta bënte të njëjtë. Pra, moda dritën e daljes e kishte në dasëm dhe përformonte po aty. Këtë angazhim kishin vajzat dhe gratë në atë kohë, ato nuk shkollheshin. Nga bankat e shkollës fillore, ose pa mos u ulur asnjëherë në ato, uleshin në "*bankën*" e quajtur "*tullar për të vejtur*" që të bëheshin gati për nusëri. Sa ëndrra janë shuar në ata tullarë! Sa vajza u mbyllën nga mentaliteti patriarkal i asaj kohe. Por, kishte dhe nga ato që nuk i dorëzonin lehtë ëndrrat e thurura; natën, kur të gjithë mendonin se ato vejnjin, ato lexonin romane nën dritën e llambës.

Vajzat, nisnin që të beheshin gati për martesë pasi fillonin të rriten pak, ose thënë ndryshe pasi hynin në pubertet. Disa i fejonin shumë të reja e disa "*ngelnin*" pa fejuar edhe pas moshës 20-vjeçare. Fejesa zgjaste vite me radhë, pasi vajzës i duheshin vite të tëra që ta bënte veshjet e saj që duhej t'i kishte kur do të shkonte nuse. Fejesa mund të zgjaste edhe deri në 5 vjet e më shumë. Ajo përveç që duhej t'i përgatiste veshjet me të cilat duhej të vishej kur do të nusëronte, duhej të përgatiste edhe veshje për jeten e saj të përditshme dhe dhurata për gjithë familjen e burrit. Familjet ishin të mëdha e i duhej kohë për të thurur me duart e saj dhurata për të gjithë, dikujt këmishë e dikujt çorape, dikujt jaka e dikujt mindil, dikujt dizgë e dikujt brez, nogajca për njërën e peshterkë për tjetrën, t'ua përshtasë për gjininë dhe moshën. Sa shumë punë për një vajzë, për një grua!!!

Kjo nuk mbaronte me martesën, ajo vazhdonte të bëjë "*punë dore*" edhe pastaj. Vejte këmisha, qilima, jastëkë, mbulesa, pastaj thurte çorape për burra dhe për fëmijë, për gra e për vajza. Pra kjo punë e përgatitjes së veshjes i ka ndjekur nga pas thujtë të gjithë jetën.

### Motivet në veshjet e grave

Kur sheh veshjen popullore kërcovare të jep një ndjesi të jashtëzakonshme bukuria dhe bagatia e saj. Në shikim të parë të zë "*frika*" se nuk do të mund të arrish të shpjegosh atë që sheh, pasi ajo ka shumë elemente me motive të ndryshme. Secili prej tyre ka në vete një domethënie si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Nga motivet e larmishme që ishin dhe



janë pjesë e dekoracionit të tyre, dallohen motivet: gjeometrike, kozmike, zoomorfe, fitomorfe, antropomorfe, e të tjera (Murtezani, f. 5). Të gjitha këto motive në veshje që do t'i bëjë njeriu kanë qënë për arsyse të ndryshme. Ka qënë frika nga e panjohura, frika nga vdekja. Andaj, njeriu mbështetej te zoti, te besimi i tij. Ai ishte kulti i tij dhe për nder të tij e vinin dhe në trup, në veshjet e tyre.

Në bisedat që zhvillonim me gratë flisnin me një pasion të madh për mënyrën e bërjes së veshjeve, sidomos shumë me krenari e tregonin se me sa vija e kanë pasur këmishën, se dikush e paska bërë me më shumë fije (vija) se tjetra, se ajo paska qënë e para që e ka bërë ashtu këmishë (Lazime Çeliku, 69 vjeçare, Lutfije Adili, 60 vjeçare etj). Pra, vija është një figurë gjeometrike shumë e pranishme në këmishat, peshterkat, dizgat, jakat, mëngët e grave të Kërçovës me rrethinë. Vijat horizontale në këmishat e grave simbolizojnë këtë botë, por edhe ato vertikale kanë simbolin e kësaj bote por edhe të vdekjes. (Murtezani, f. 5) Vijave u këndojnë edhe këngë në dasma, si:

“Qekne vesh moj nouse vija-vija  
Njifet se ke hec me dimija”

Përveç vijave vertikale dhe horizontale shumë e pranishme është edhe qëndisja zig-zake e këmishave në pjesë të ndryshme të saj. Zig-zakja ka qënë e pranishme edhe në veshjet ilire siç shkuran profesor Murtezani bazuar në studimet e Stipçeviçit që ka bërë për ilirët. (Murtezani, f. 5). Ky elemend sjell kultin e gjarpërit në të cilin besonin ilirët, gjë që besohet edhe në Kërçovë dhe në fshatrat e banuar me shqiptarë. Gjarpri që dilte në temelin e shtëpisë asnjëherë nuk duhej që të vritej pasi besohet se ai e ruan shtëpinë dhe se ai nuk të sulmon asnjëherë. Kështu besonin dhe gjyshja e gjyshi (Selvije dhe Musa Adili), të cilët ishin të lindur në fillim të shekullit XX.

Një figurë gjeometrike tjetër shumë e pranishme është rrethi-kollcja, trekëndshi, katrori, rombi. Çorapet janë ndarë në bazë të asaj se me sa kollce janë bërë, por burrat kanë qënë me një kollce, ndërsa për gra dhe fëmijë kanë pasur më dy, tre e më shumë.

Trekënëshi simboli i pjellshmërisë ka qënë i qëndisur në peshterkat e grave. Peshterka e kuqe e nuseve në të dyja anët, nga lart poshtë ka pasur të qëndisur trekëndësja. Një gjë e tillë nuk ka qënë te peshterkat e vajzave dhe grave më plaka. Vajzat kanë pasur “*xhesh*” peshterka të bardha pa asnjë elemen. Peshterka e bardhë te vajzat ka simbolizuar pastërtinë, pafajsinë dhe virgjërinë e tyre. Peshterkë të kuqe do të “*xhishnin*” ditën që do të shkonin nuse dhe ashtu do të mbanin derisa të bënin njëfarë moshe. Rreth ngjyrës së kuqe është hulumtuar shumë, ajo është në mes dy ngjyrave të jetës, është lindja dhe perendimi i diellit. Në një nga studimet thuhet se nuset kanë mbajtur këtë ngjyrë për të larguar syrin e keq nga pjesa e trupit që do të sillte pjellshmëri, vazhdimin e njerëzimit. Prandaj, pasi gratë

mbaronin me lindjet e fëmijëve nisnin dhe "xheshnin" peshterka të bardha, ose të zeza kur bënin një moshë të shtyer.

Elementet kozmike janë shumë të pranishme në veshjet e grave, si: ylli, hëna, dielli të cilat gjithashtu kanë qenë shumë të pranishme në veshjet ilire. Sipas sqarimeve që jep studiuesi Murtzani, dielli simbolizon anët e botës si horizontale ashtu edhe vertikale. Hëna, poashtu, gjysmëhënën e kanë qëndisur gratë në veshjet e tyre, me të cilin simbol kanë dashur të paraqesin fuqinë e gruas, hyjneshën nënë, mbretreshën e qiellit. Yllin e përdorin shumë për zbulimin e këmishave, sidomos e vënë në krahet e këmishës, përveç që e qëndisin, në kohët e fundit e vënë edhe prej ari. E gjejmë pesërremësh dhe paraqet: dominimin, amshimin, pavdekshmërinë.

Simbolikë tjetër shumë e pranishme në veshjen popullore të grave është edhe prania e zoomorfeve, ose thënë ndryshe shpendët. Kemi zogun, shqiponjë, këmbët e arushës, këmbë laraskre, peshku, flutura etj. Shqiponja parqet simbolin kombëtar por jo vetëm aq, ajo është edhe figura mitologjike. Gratë e bënin temenanë në formë shqiponje, e vinin në peshterka të tyre, e bënin bishtin në formë shqiponje, e gjejmë te petat e tyre, e kështu me radhë. Zogu përdoret për zbulime, i punuar me rruaza dhe ar, i vënë në pjesë të dryshme të këmishës apo në elemente tjera të veshjes. Kemi zog, i cili i ka hapur flatrat dhe do të fluturojë në lirinë e tij, një simbolikë me një domethënie shumë të madhe. Shumica e çifteve që martoheshin as që njiheshin me njëri-tjetrin, nuk kishin ndonjë ndjenjë për njëri-tjetrin. Ato bënin si thoshin të fisit. Dhe zogu duke fluturuar mund të ishte vetëm në veshjet e tyre pasi një liri të tillë ato nuk e gëzonin në jetën e tyre. Por në zbulimin e veshjeve gjejmë edhe dy zogj kokë më kokë, një simbolizim i dashurisë në mes dy të rinjëve që po nisnin një jetë të re. Simbol tjetër i dashurisë ishte dhe zemra me shigjetë në mes, shigjeta e Kupidit. Peshku, ose punimet e dorës me formë peshku i përdorin gratë për t'i vënë në shpinë për ta zbuluar jelekun...

Ajo që e bën edhe më të veçantë këtë veshje dhe shumë të rëndësishme për t'u marrë etnologët me të, është prania e elementeve antropomorfe, si: koka e vajzës, syri i njeriut, duart, figura e nuses, figura e vajzës etj. Veshja e grave zbulohet edhe me figurën e vajzës së bukur, me flokë të gjata e me buzë të kuqe. Jeleku i ditës së martesës ishte i qëndisur me figurën e nuset, trupin e saj dhe kokën. Në bisedë me gratë që i kanë qëndisur vajzat në veshjet e tyre kuptuam se gjyshërit e kanë kundërshtuar një figurë të tillë në veshjet e tyre, pasi kanë besuar se figura do të kërkojë shpirtë në jetën tjetër dhe se është mëkatë të qëndiset në veshje popullore figura e njeriut. Njeriu krijohet nga zoti, ai i jep jetë dhe frymë, dhe se figura pa jetë është besuar që do të kërkojë llogari në botën tjetër. Syri qëndiset për t'i dhënë një hijeshi veshjes dhe për ta mbrojtur nga shpirtat e ligë. Duart kanë filluar më vonë të qëndisen. Ata qëndiseshin për të paraqitur forcën e njeriut. Ky trend filloi nga periudha komuniste dhe konsiderohej se ishte element partie.

Rrushi, molla, dardha, qershia, thana e shumë fruta tjera janë të pranishme në zbukurimin e veshjeve të grave të kësaj anë. Simbolizim i besimeve që kishin njerëzit. Rrënja, kërcelli dhe degët simbolizojnë tokën, ajrin dhe qiellin. Në festën e Ditës së Verës gratë besoni shumë në fuqinë që jepte thana, lidhja e perit të bardhë dhe të kuq në degën e mollës të sillte një shëndet të plotë, prandaj i kemi të pranishme fitomorfet në këto veshje, simbolizojnë një lashtësi kur besohej në shumë zotra dhe zotrat i kishin kulte dhe i banin edhe në veshjet e tyre. Motivet fitomorfe janë nga më të përhapurat, lule të ndryshme, gjethe të shumta qëndisnin gratë për t'i zbukuruar veshjet e tyre. Kemi lule diellin, lulen e badrrës, lulen e haranjellit, gjethet e goshës, gjethe e badrrës, gjethet e rrushit e tjera.

### Fazat e përgatitjes së veshjeve popullore.

Deri në vitet 80-ta, por edhe 90-ta, gratë në fshatrat e Kërçovës ecnin të veshura "me të gjata", ndërsa kur ishin të pamartuara ecnin me dimia. Veshja e tyre ka evulura duke ndryshuar shumë ndër vite. Ka ndryshuar materiali i teshave, ngjyrat, zbukurimet e saj, por ajo që ka ngelur e njejtë është mënyra e bërjes së veshjeve. Përgatitja e veshjes popullore të grave ka pasur disa faza, si: sigurimi i materialeve (prodhimi i mëndafshit), enja, mulesa, veprimi, vejtja, prerja, qepja dhe në fund veshja e saj.

#### Faza e parë: PRODHIMI I MËNDAFSHIT

Kjo ka qënë një nga fazat më të rëndësishme për të gjitha llojet e veshjeve që janë bërë. Në periudha të ndryshme kohore materialet janë siguruar në rrugë dhe mënyra të ndryshme. Ne do të ndalemi dhe do të tregojmë se si janë grumbulluar dhe bërë materialet deri në vitet 70-ta e më herët. Pas viteve 70-ta ka qënë më e lehtë sigurimi i materialeve pasi ka ndryshuar ekonomia e vendit, njerëzit kanë filluar më shumë të lëvizin në shtete të ndryshme, për arsye që tash më dihen. Zhvillohet më shumë teknologjia, teknika, ekonomia, edhe veshja popullore ka qënë e lidhur ngushtë me rrethanat ekonomiko-shoqërore që ka pasur vendi. Matreliaret që kanë përdorur për bërjen e veshjeve popullore kanë qënë: mëndafshi (munashi), sfilla, pambuku, çenouri, leshi, teli.

Ajo që bie në sy dhe që është shumë interesante, është mënyra e sigurimit të mëndafshi. Gratë kanë siguruar farën e bubave\* nga njëra-tjetra dhe i kanë mbajtur në gji të rrinë ngrohtë. Në atë mënyrë janë rritur. Në gji i kanë mbajtur disa ditë, i kanë kontrolluar vazhdimisht që të shohin a kanë filluar të bëjnë vezë. Pas disa ditësh, deri në 10, kanë filluar që bubat të bëjnë krimba. Kur kanë bërë krimbat i kanë marrë dhe i kanë vënë në shoshë, e cila ka qënë e mbushur me gjethe të freskëta mani. Shoshën e kanë vënë në një vend të dhomës që të rrinë ngrohtë. Çdo ditë i kanë ushqyer me gjethe të freskëta mani. Pasi janë shtuar ato e është mbushur

plot shosha, i kanë vënë në një vend me të gjerë, si në kevat apo në të gjithë dhomën. Krimbave u kanë vënë degë mani mbushur me gjethe dhe kanë hipur nëpër ato degë dhe janë ushqyer. Tri herë në ditë është dashur që t'u shtihet gjethe mani, të freskëta dhe të pastra, deri sa të rriten sa një gisht i dorës. Pasi bëhen aq të mëdhenj dhe krijojnë kozhurkën e tyre, krimbi futej brenda dhe fillonte prodhimin e mëndafshit. Prodhon mëndafsh deri sa ka vend në shtëpizën e tij. Pasi të gjithë krimbat mbarojnë me prodhimin e mëndafshit, pas gjashtë javësh, gratë i merrnin këto dhe i futnin në një kazan me ujë të nxehtë. Në mes të kazanit vihej boshti dhe aty ngjitej fija e mëndafshit nga krimbat, dhe ato e lëshonin mëndafshin e tyre. Gratë e nxirrnin mëndafshin duke e hequr me dorë, hollë e mirë, dhe e vinin në një gjatësi prej gjysmë arshini\* në një dru. Pasi e nxirrnin gjithë mëndafshin, e merrnin dhe e tjernin me një letkë e pastaj i bënin gupa te rodoni. Disa krimba bënin mëndafsh të bardhë, disa bënin mëndafsh të verdhë. Kështu që materiali për këmishë ishte i bardhë dhe i verdhë. Duhet të theksohet se gratë ruanin disa buba për farë, pasi nuk duhej asnjëherë të shuhej fara e tyre. Bubabë ishin shumë të nevojshëm për veshjet. Ato duhej t'u jepnin farë edhe grave tjera që ta vazhjojnë procedurën dhe traditën e veshjeve prej mëndafshi. Krimbat e mëndafshit ruheshin me shumë fanatizëm, ruheshin edhe nga syri i keq, u këndoheshin edhe vargje. Më poshtë sjellim disa vargje që na kujtohen që i recitonim kur ishim fëmijë.

“Zogu, zogu laramani!  
Më dhuro ca gjethe mani!  
Të ja jap për ushqim!  
Krimbit mëndafshit tim!  
...”

(Vargje që thonin fëmijët për krimbat që prodhonin mëndafsh)

Pambuku, siguroheshte nga vende të ndryshme dhe vajzave të fejuara u dërgoheshin me topa-topa për ta përpunuar vetë ato pastaj. E tjernin me letkën dhe pastaj me radonin e vërteshknë e bënin gupa-gupa për ta bërë pastaj pëlhurë. Pambuku ishte me ngjyrë të bardhë dhe kur u duheshte të jetë me ngjyrë tjetër e dërgonin në qytet te bojaxhiu që ta njirosin me ngjyrën që donin ato.

Faza e dytë: ENDJA

Kjo është fazë shumë e rëndësishme për bërjen e materialit për veshje. Duhet të përmendet se, jo të gjitha gratë dinin që të “esin”, gratë që e bënin këtë punë ishin mjeshtrë të kësaj pune duke pasur përvojë në këtë fushë, ishin pak më të vjetra. Enjen e këmishës e bënin me një “irrenek” të marrë nga tradita dhe shpesh herë i jepnin doza të një mode të fundit. Pra, gjatë kësaj faze gratë nxirrnin edhe irreçe të reja.

Si behej enja e këmishës? Në fillim duhej të sigurohej një hapësirë shumë e gjerë dhe shumë e gjatë, deri në 30 metra gjatësi, vend i pastër dhe me mundësi për të punuar lirshëm. Në një mur të gjatë vendoseshin kunjat në largësi të caktuar njëri nga tjetri, varësisht prej modelit të këmishës që duhej të bënin, dhe gratë lëshonin penjtë e përgatitur më parë. Ato ishin vetëm mëndafsh, ose e kombinonin me ndonjë material tjetër që kishin. E endnin perin duke e kaluar nëpër kunjat para mbrapa, poshtë-lart.

Pasi endet materiali, hiqet nga kunjat dhe lidhet lehtë së formë gërshete që të jetë gati për të kaluar në fazën e tretë, në fazën e mbulesës.

#### Faza e tretë: MULESA

Në këtë fazë të bërjes së këmishës, dizgës apo brezit, ose diçkaje tjetër, gratë bëjnë mulesën. Në vërçallkë vëndohej materiali i endur. Vërçallka është mjet special i bërë për të mbajtur materialin që pastaj behej këmisha. Sipër i viheshin disa gurë të rëndë me qëllim që penjtë të hiqen nga ana tjetër e vërçallkës dhe të futen në shul. Shuli ishte një dur i gjatë sa gjersia e tullarit. Ka pasur vrimë të gjatë gati sa është ai vetë ku futen fijet në fillim dhe pastaj vazhdon rrotulimi dhe mbushja e shulit në formë të një makareje të madhe me fije. Nga ana tjetër ngadalë afrohet vërçallka drejt shulit deri sa mbaron materiali për t'u futur në shul.

#### Faza e katërt: VEPRIMI

Materiali i mbulura, pra i rrotulluar rreth shulit, tani shkon më në tullar. Tash puna kalon më në ambientet e shtëpisë, jo më në natyrë siç duhet të jetë në fillim. Vihej shuli në pjesën e pasme të tullarit dhe fijet tani duhet të kalojnë nëpër liçtë. Mjeshtret e veprimit kalojnë çdo fije nëpërmejt fijeve të liçve, në dy liç më herët e në katër liç pas viteve 80-ta, për t'i futur në shpatë e për të përfunduar te shuli nga ana e parme e tullarit.

#### Faza e pestë: VEJTJA

Pasi është bërë gati materiali për t'u vejtur, fillon vejtja e tij. Këtë punë kanë ditur ta bëjnë thujse të gjitha vajzat dhe gratë. Në bisedat që kishim me gratë gjatë periudhës së veljes së materialit, na thonin se rrallë ka pasur vajza që nuk kanë ditur të vejnin, thujse asnjë. Për një këmishë duhej të vejej gjashtë metra material. Në një tullar zakonisht viheshin më shumë se pesë këmisha përnjërazi për t'u vejtur, pra gjithë ajo procedurë që përshkruam sigurisht që nuk bëhej për një këmishë, por beheshin deri në gjashtë këmisha. Vejtja e tyre vareje prej impenjmit të asaj që e bën këtë punë. Zgjaste me javë të tëra. Për t'u bërë "gate:j" vajzat vejnin disa herë nga gjashtë këmisha, apo breza e dizga, nogajca e jaka.